

237



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E AELIT
TIRANË

Nr. 104 REGJ.THEMELTAR
Nr. 106 I VENDIMIT

V E N D I M

“ N Ë E M Ë R T Ë R E P U B L I K Ë S ”

Gjykata e Apelit Tiranë, e përbërë nga gjyqtarët :

KRYESUES : METUSH SARAÇI
ANËTAR : FLUTURA SKËNDERI
ANËTAR : FATOS QATO

Sot, me date 08.11.2007 shqyrtoi ne shkalle te pare çeshtjen civile qe i perket :

KERKUES : La Petrolifera Italo – Albanese sh.a., me adrese: Bulevardi “Zhan D’Arka”, kulla jeshile “Teknoprojekt” Nr.2, Ap.1, Tirane, i perfaqesuar nga Drejtori i Pergjithshem Z.Giudo Ottolenghi, i perfaqesuar me prokure te posaçme nga av.Krenar Laloçi.

OBJEKTI : Njohja e vendimit te Gjykates Nderkombetare e Arbitrazhit, prane Dhomes Nderkombetare te Tregtise, Paris, me numer 14420/FM, date 25.07.2007, me pale kerkuese: La Petrolifera Italo-Rumena s.p.a., dhe La Petrolifera Italo-Albanese sh.a., dhe pale mbrojtese, Republika e Shqiperise, me

238

- 2 -

objekt: njohjen e marreveshjes se zgjidhjes me mirekuptim ndermjet paleve te permendura me siper.

BAZA LIGJORE : *Neni 393 e vijues te K.Pr.Civile.*

GJYKATA E APELIT TIRANË

mbasi shqyrtoi çeshtjen, administroi provat e nevojshme bashkangjitur kerkeses, degjoi perfaqesuesin e pales kerkuese av.Krenar Laloçi, i cili kerkoi pranimin e kerkeses, av.e shtetit Ferdinand Caka qe u shpreh per njohjen e vendimit te Gjykates Nderkombetare te Arbitrazhit Paris, dhe pasi e bisedoi e analizoi çeshtjen ne teresi,

V Ë R E N

Ne shqyrtimin gjyqesor te çeshtjes, rezultoi e provuar se me vendimin e Gjykates Nderkombetare te Arbitrazhit, prane Dhomes Nderkombetare te Tregtise ne Paris, me numer 14420/FM date 25.07.2007 me pale kerkuese La Petrolifera Italo-Rumena s.p.a., e La Petrolifera Italo-Albanese sh.a., dhe pale mbrojtese Republika e Shqiperise eshte vendosur :

- Konstatimi se palet e kane zgjidhur plotesisht mosmarreveshjen e tyre sipas Marreveshjes se Zgjidhjes me Mirekuptim, te nenshkruar me 10 Maj 2006 dhe se palet kane hequr dore nga te gjitha pretendimet e tyre ne kete procedure arbitrazhi,

- Urdherimet e paleve qe te zbatojne kushtet e Marreveshjes per zgjidhe me Mirekuptim;

- Shpall se kerkuesit dhe i Padituri do te paguajne secili gjysmen e shpenzimeve te procedures se arbitrazhit, te cilat jane percaktuar nga Dhoma Nderkombetare e Arbitrazhit ne masen 30.000 Dollare Amerikane si pasoje, ne baze te pagesave te kryera nga kerkuesit (30.000 Dollare Amerikane), Urdheron Republikën e Shqiperise qe te rimbursoje kerkuesit per shumen 15.000 Dollare Amerikane.

- Lë ne ngarkese te seciles Pale tarifate dhe shpenzimet e tjera te bera per mbrojtjen e saj.

Shqyrtimi gjyqesor i çeshtjes vertetoi se kërkesa e pales kerkuese La Petrolifera Italo-Rumena s.p.a., e La Petrolifera Italo-Albanese sh.a., ka baze ligjore e per rrjedhoje duhet te pranohet.

Ne kete konkluzion arrihet, se ne baze te legjislacionit te shtetit shqiptar, Gjykata Nderkombetare e Arbitrazhit, prane Dhomes Nderkombetare te Tregtise, Paris, nuk ka patur pengese ligjore ne shqyrtimin e kesaj çeshtje dhe vendimi i dhene prej saj ka qene ne kompetence te asaj Gjykate Arbitrazhi.

Keshtu, ne nenin 17 te Marreveshjes se Konkensionit te lidhur ndermjet Paleve me 24 Maj 2004, parashikohet :

“Te gjitha mosmarreveshjet qe do te dalin ose rrjedhin nga kjo Marreveshje e Konkensionit per, do te trajtohen e zgjidhen nepermjet arbitrazhit nderkombetar (siç parashtrohet ne nenin 17 te Ligjit nr.7973, date 26.07.1995) ne perputhje me Rregullat e Arbitrazhit te Dhomes Nderkombetare te Tregtise, nga nje ose me shume arbitra te caktuar ne perputhje me Rregullat e siperpermendura. Arbitrat do te zbatojne dhe marrin vendime duke u bazuar ne te drejten Franceze. Vendi i Arbitrazhit do te jete Parisi. Gjuha e Arbitrazhit do te jete Anglishtja. Vendimi i dhene nga arbitri do te jete detyrues dhe perfundimtar per Palet”.

Gjykata Nderkombetare e Arbitrazhit, Paris, ka zhvilluar nje proces te rregullt ligjor dhe Paleve ne proces u eshte dhene mundesia per te parashtruar te gjitha pretendimet e tyre.

Kerkesa e paraqitur nga pala Kerkuese para Gjykates se Apelit Tirane, per njohjen e Vendimit te Gjykates Nderkombetare te Arbitrazhit Paris, me numer 14420/FM, date 25.07.2007 eshte ne perputhje me te gjitha percaktimet ligjore te shprehura ne Kreun IX *“Njohja e vendimeve te shteteve te Huaja”*.

Ne njohjen e ketij vendimi, nuk ekziston asnje pengese ligjore per t'i dhene fuqi zbatimit te tij ne Republiken e Shqiperise.

Ne nenin 394 te K.Pr.Civile jane percaktuar pengesat ligjore, per zbatimin e vendimeve te dhena nga gjykatat e huaja.

Ne çeshtjen ne shqyrtim, Kolegji Civil i Gjykates se Apelit, konstaton se nuk ekziston asnje pengese ligjore e percaktuar ne dispoziten proceduriale te sipercituar, qe te mos lejoje dhenien fuqi te vendimit Nr.14420/FM, date 25.07.2007 i Gjykates Nderkombetare te Arbitrazhit Paris. Gjykimi i zhvilluar nga kjo Gjykate (Arbitrazhit) eshte ne pajtim te plote me parimet baze te legjislacionit shqiptar.

Referenca ligjore per njohjen e vendimit te Arbitrazhit, eshte neni 399 i K.Pr.Civile ne te cilin shprehet *“Dispozitat e ketij Kreu zbatohen edhe per njohjen e vendimit perfundimtar te nje arbitrazhi te shtetit te huaj”*.

240

- 4 -

Edhe ne pikpamje te te provuarit, kerkimet e pales kerkuese shoqerohen me te gjitha provat e administruara ne Gjykatën Nderkombetare te Arbitrazhit.

Keshtu, midis akteve ndodhet vendimi i Gjykates Nderkombetare te Arbitrazhit, ne gjuhen Angleze e perkthyer ne shqip dhe e legalizuar nga noteri; marreveshja per zgjidhjen me Mirekuptim date 10 Maj 2007 se bashku me tre shtojcat e saj; Vendimi Nr.235, date 27.04.2007 i Keshillit te Ministrave, si dhe nje seri aktesh te tjera te depozituara se bashku me kerkesen.

Ne keto kushte, çmohet, se kerkesa e paraqitur nga pala Kerkuese eshte e bazuar ne ligj, e si e tille ajo, duhet te pranohet.

PËR KËTO ARËSYE

Gjykata e Apelit Tirane, bazuar ne nenet 393 – 399 te K.Pr.Civile,

V E N D O S I


Njohjen dhe dhenien fuqi te vendimit te Gjykates Nderkombetare te Arbitrazhit ne Paris, Nr.14420/FM, date 25.07.2007, qe iu perket paleve: La Petrolifera Italo-Rumena s.p.a., e La Petrolifera Italo-Albanese sh.a., dhe pale mbrojtese Republika e Shqiperise, me objekt: njohjen e Marreveshjes te Zgjidhjes me mirekuptim ndermjet ketyre paleve.

Tiranë, më 08.11.2007

**ANËTAR
F. QATO**



**ANËTAR
F. SKËNDERI**



**KRYESUES
M SARACI**

